



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 7.4.2023

Nr: 304

Ora: 13:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË MISIONIT TË OSBE-ODIHR PËR VËZHIMIN E ZGJEDHJEVE PËR  
ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot, më datë 7.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën me:

- KËRKUES:** Misioni i OSBE-ODIHR për Vëzhgimin e Zgjedhjeve
- OBJEKTI:** Kërkohe akreditimi për vëzhgues afatgjatë për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023
- BAZA LIGJORE:** Nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimi nr. 19, datë 27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”

V Ë R E J:

Misioni i OSBE-ODIHR për vëzhgimin e zgjedhjeve i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për 38 (tridhjetë e tetë) vëzhgues afatgjatë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5 të Kodit Zgjedhor. Misioni i OSBE-ODIHR për Vëzhgimin e Zgjedhjeve është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje përcaktuar në nenin 6, pika 2 e Kodit Zgjedhor.

Data: 7.4.2023 Nr: 304  
Ora: 13:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së misionit të OSBE-ODIHR për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”

## **PËR KËTO ARSYE:**

Në mbështetje të neneve 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 19, datë 27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

## **V E N D O S :**

1. Akreditimin si vëzhgues afatgjatë për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, të 38 (tridhjetë e tetë) vëzhguesve afatgjatë të Misionit të OSBE-ODIHR për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**